



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Raport për periudhën Prill-Qershor 2021

Oda e Mjekëve të Kosovës



Korrik 2021

Prishtinë

Përmbajtja:

Raport për periudhën Prill-Qershor 2021	1
1. Infrastruktura Juridike	3
2. Këshilli Drejtues.....	4
3. Anëtarësimi	5
4. Mbikëqyrja etiko-profesionale	6
5. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional	7
6. Licencimet.....	7
7. Edukimi specialistik - zbërthimi i kompetencës bazuar në Ligjin për Shëndetësi dhe Ligjin për OPSH-të	8
8. Këshilli Mbikëqyrës	8
9. Komisioni për çështje Etike i OMK-së	8
10. Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke	8
11. Raporti financiar.....	9
11.1 Raporti financiar për periudhën deri me 31 maj 2021	9
11.2 Përkrahje për Edukim të Vazhdueshëm Profesional	10
11.3 Prokurimi	10
12. Aktivitete të tjera	10
12.1 Botimi i Revistës Mjeku	10
12.2 Kongreset vjetore	11
12.3 Obelisk kushtuar punëtorëve shëndetësor	11
12.4 Hulumtim - Të nxëniet e harmonizuar/kompetencat e mjekëve të përgjithshëm.....	12
12.5 Hulumtim - Kënaqshmëria e specializantëve me shkollimin specialistik në QKUK dhe Spitale Rajonale	12
12.6 Bashkëpunimi profesional dhe veprimtaria ekspertike	13
13. Plani i veprimit për vitin 2021	13

1. Infrastruktura Juridike

Me datë 15 qershor 2021 u mbajt mbledhja e VIII e legjislaturës së dytë e Kuvendit të OMK-së. Në këtë mbledhje u shqyrtuan dhe miratuan amandamentet për plotësim-ndryshimin e rregulloreve dhe u miratuan aktet të reja normative si në vijim :

- U miratuan plotësim-ndryshimet e Rregullorës së EVP-së;
- U miratuan plotësim-ndryshimet e Rregullorës për Marketing;
- U miratuan plotësim-ndryshimet e Rregullorës për procedurat vendimmarrëse të Organeve të OMK-së;
- U miratuan aktet e reja normative si Kodi Zgjedhor i OMK-së dhe Rregullorja për “Revistën Mjeku”.

Gjithashtu në këtë mbledhje u morrën vendimet si në vijim :

- Vendim për zgjedhjen e anëtarëve të KQZ-së;
- Vendim për aprovimin e raportit të Punës për periudhën janar-maj 2021;
- Vendim për Miratimin e Buxhetit të Rishikuar të OMK-së për vitin 2021;
- Vendim lidhur me kuotën e antarësisë për mjekët shtetas të huaj;
- Vendim për caktimin e datës për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të OMK-së, e cila u caktua për datë 09 nëntor 2021.

2. Këshilli Drejtues

Në periudhën kohore Prill–Qershor 2021, Këshilli Drejtues i OMK-së ka mbajtur katër (4) takime, ku janë shqyrtuar lëndët si më poshtë:

Organi	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën Prill-Qershor	Vendimet sipas kërkesave/ ankesave të pranuar për periudhën Prill-Qershor	Vendimet në procedurë	Vendimet e Këshillit Drejtues për periudhën Prill-Qershor	Vendimet për lëndët e bartura nga periodat paraprake
Këshilli Drejtues i Odës	8	7	1	1-Vendim –Aprovohet kërkesa e Klinikës së Hematologjisë për dhurimin e dy (2) kompjuterëve; 2-Vendim –Aprovohet kërkesa e Klinikës së Nefrologjisë për dhurimin e një (1) kompjuteri; 3-Vendim –Aprovohet kërkesa e Klinikës së Ortopedisë për dhurimin e dy (2) kompjuterëve; 4-Vendim – Aprovohet Draft-Kodi Zgjedhor i OMK-së; 5-Vendim – Caktohet data e mbajtjes së Kuvendit të OMK-së; 6-Vendim – Aprovohet Draft-Plani Buxhetor i Rishikuar; 7-Vendim – Aprovohet Raporti i Punës i Tremujorit të parë 2021; 8-Aprovohet Draft- Rregullorja për Revistën Mjeku; 9-Aprovohen Propozimet e KEVP-së për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullorës së EVP-së; 10-Vendim për lirim nga taksa për lejhulumtime studentët e Fakultetit të Mjekësisë; 11-Vendim për kompenzimin e anëtarëve të Këshillit Organizativ dhe Këshillit Shkencor për 2 kongreset.	1

3. Anëtarësimi

Gjatë periudhës Prill-Qershor 2021, në Odën e Mjekëve të Kosovës u anëtarësuan 78 mjekë, nga të cilët janë 7 mjekë të punësuar në sektorin publik, 7 mjekë të punësuar në sektorin privat dhe 64 mjekë të papunë.




Tabela 1.1: Anëtarësimet për periudhën Prill-Qershor 2021




Tabela 1.2: Totali i përgjithshëm i anëtarëve deri më datën 30 qershor 2021

Gjatë kësaj periudhe janë ndarë nga jeta 2 mjekë si dhe është rianëtarësuar 1 mjek, si rezultat numri total i anëtarëve deri me datën 30 qershor është 4640 mjekë.

4. Mbikëqyrja etiko-profesionale


Për ta pasqyruar ecurinë e mbikëqyrjes etike dhe profesionale pranë organeve të Odës, në mënyrë tabelare do të paraqesim ushtrimin e funksionit të tillë nga ana e organeve të odës.

Organi	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën Prill-Qershor	Vendimet sipas procedurës së zhvilluar për periudhën Prill-Qershor	Sanksionet e shqiptuara për periudhën Prill-Qershor	Sanksionet e ekzekutuara për periudhën Prill-Qershor	Lëndët e bartura nga periudhat paraprake	Lëndët në shqyrtim
Prokurori i Odës	11	21	///	///	34	33
Këshilli Etik	16	16	Rekomandime kolegjiale 5 Qortim Publik 1 Gjoha : 0 gjoha Gjithesëj : 0 00.00€	Qortim publik 0 (00.00€) Gjoha 0 (0.00€) Gjithesëj: 00.00€ Shpenzime te paushallit : 300€	16	16
Gjyqi i Nderit	4	6	1) Refuzohet ankesa GJN 03/2021 ndaj Vendimit të Këshillit Etik KE 74.49-14/2021. 2) Refuzohet ankesa GJN 02/2021	///	1	0
Certifikatat e të kaluarës etike	32	///	///	///	///	///

Në shqyrtime të drejtpërdrejta janë mbajtur gjithsej një (1) takim i Gjyqit të Nderit për shqyrtimin e këtyre lëndëve.


5. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional

Komisioni për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional gjatë periudhës Prill-Qershor 2021 ka akredituar 31 aktivitete. Në kuadër të aktiviteteve të akredituara, dy shoqata kanë bërë kërkesë për përkrahje financiare për organizimin e aktiviteteve, kërkesa këto që edhe janë aprovuar nga Komisioni.



6. Licencimet

Komisioni për Licencim dhe Rilicencim profesional gjatë periudhës Prill-Qershor 2021, ka organizuar 3 provime të rilicencimit dhe gjithashtu ka lëshuar 162 licenca me kategoritë si në grafikun e mëposhtëm:



7. Edukimi specialistik - zbërthimi i kompetencës bazuar në Ligjin për Shëndetësi dhe Ligjin për OPSH-të

Dizajnimi dhe fillimi i fazës kalimtare të zbërthimit të kompetencave të edukimit specialistik (zbërthimi ligjor, financiar dhe teknik) është në proces e sipër, duke përfshirë edhe hartimin e UA-së për shkollim specialistik.

Por në ndërkohë, bazuar në Nenin 9, paragrafi 1, me nënparagrafin 1.7, të Ligjit për OPSH-të, si dhe Nenin 72, paragrafi 5, të Ligjit për Shëndetësi, OMK ka kërkuar auditim të procesit pasi që ka konstatuar dhe faktuar një mori shkeljeve ligjore. Procesi i auditimit ka filluar nga ana e MSh-së.

8. Këshilli Mbikëqyrës

Në periudhën kohore Prill-Qershor 2021, Këshilli Mbikëqyrës i OMK-së ka mbajtur tre (3) takime, ku i kanë shqyrtuar Rregulloret dhe vendimet e Kuvendit të fundit të OMK-së si dhe kanë shqyrtuar vendimet e Këshillit Drejtues.

9. Komisioni për çështje Etike i OMK-së

Në periudhën kohore Prill-Qershor 2021, Komisioni për Çështje Etike i OMK-së ka pranuar katër (4) kërkesa për leje për hulumtim dhe ka shqyrtuar katër nga këto kërkesa. Katër kërkesat e parashtruara nga palët janë aprovuar, dhe aplikuesëve u janë lëshuar lejet për hulumtim.

10. Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke

Në periudhën kohore Prill-Qershor 2021, Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke ka pranuar shtatë (7) kërkesa për përkrahje financiare. Komisioni ka marrë vendim aprovues lidhur me këto kërkesa.

11. Raporti financiar**11.1 Raporti financiar për periudhën deri me 30 qershor 2021**

1.0 Të hyrat:				
1.1 Të hyrat e shtyera nga 2020	€		475,907	
Të hyrat e shtyera nga 2020			1.1 Të hyrat e shtyera nga 2020	€ 475,907
1.1 Të hyrat	Realizimi: TM1	Realizimi: TM2	TOTAL	
1.1.1 Të hyrat nga anëtarësia:				
1.1.2 Anëtarësimi i mjekëve shtetas kosovarë	€	264,512	€	62,881
1.1.3 Anëtarësimi i mjekëve shtetas jo kosovarë	€	2,000	€	5,500
1.1.4 Licencimi	€	9,700	€	7,950
1.1.5 Të hyrat e tjera*	€	8,366	€	6,805
Të hyrat deri me 30.06.2021	€	284,578	€	83,136
Të hyrat e shtyera nga 2020				€ 475,907
TOTAL TË HYRAT				€ 843,621

2.0 SHPENZIMET	Shpenzimet: TM1	Shpenzimet: TM2	TOTAL	
2.1 Paga, medetje dhe kontributet pensionale	€	40,596	€	49,786
2.2 Material shpenzues	€	4,923	€	239
2.3 Reprerentacioni	€	642	€	587
2.4 Edukimi i vazhdueshëm profesional	€	2,000	€	3,250
2.5 Shpenzimet e tjera*	€	8,793	€	8,209
2.6 Shpenzimet e aseteve			€	148
2.7 Përkrahje financiare në kuadër të fondit për solidaritet	€	8,000	€	4,250
TOTAL SHPENZIMET 30.06.2021	€	64,954	€	66,469

TOTAL BILANCI				€ 712,198
----------------------	--	--	--	------------------

1.1.5* Taksë administrative për aplikim për ndërrim të kartelës, Regjistrimi në regjistrin e anëtarësisë së OMK-së, faksimili, faksimili i dytë, kongreset, simpoziumet, seminarët, konferencat vendore pa pjesëmarrje ndërkombëtare, aktivitetet e organizuara nga kompanitë farmaceutike, certifikatat për të kaluarën etike, lejimi për hulumtime biomjekësore për anëtarë të Odës, të hyrat nga dënimet (masat disiplinore), dhurata/donacione, të ardhurat të tjera.

2.5 *Faksimili, anëtarësimi në CPME, shpenzimet e tel., shpenzimet e int., shpenzimet e postës, pajisje të TI-së, shpenzime bankare, shpenzimet e pastrimit, shpenzimet e transportit, inventari, shpenzimet e tjera operative. Organizimi i mbledhjes së Kuvendit.

2.7* Tek përkrahja për solidaritet përveç mjeteve të ndara për mjekët të cilët kanë lënguar nga ndonjë sëmundje, janë të përfshira edhe mjetet e ndara për familjet e mjekëve të cilët kanë ndërruar jetë si pasojë e infektimit me virusin COVID-19, bazuar në Vendimin e Këshillit Drejtues me nr. Ref. 53/20.

11.2 Përkrahje për Edukim të Vazhdueshëm Profesional

Oda e Mjekëve të Kosovës gjatë periudhës Prill-Qershor ka akorduar përkrahje financiare për,

- Qendrën e Mjekësisë Urgjente Prishtinë në organizimin e “Trajnimit për procedurën e intubimit të pacientit në kushte paraspitalore”, me vlerë 1,250.00 €

11.3 Prokurimi

Gjatë periudhës kohore Prill-Qershor 2021, nuk është zhvilluar asnjë procedurë e prokurimit.

12. Aktivitetet tjera

12.1 Botimi i Revistës Mjeku

Me propozim të Këshillit Drejtues në mbledhjen e Kuvendit të OMK-së në vitin 2019, u mor vendim për themelimin e Revistës profesionale të Odës së Mjekëve të Kosovës. Me 2 mars 2020 Këshilli Drejtues emëroi anëtarët e redaksisë së revistës, ku si rrjedhojë me datë 9 mars u mbajt takimi i parë i anëtarëve. Në takimin e parë u vendos që revista të jetë informative, të botohet katër herë në vit dhe u propozua që numri i parë të botohet me datë 1 qershor 2020. Për shkak të situatës së shkaktuar nga COVID-19, botimi i revistës u shty deri në stabilizim të situatës bazuar në rekomandimet e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik.

Me datë 28 dhjetor 2020 u mbajt takimi i dytë i redaksisë së revistës, ku u strukturua përmbajtja e revistës, si dhe në mënyrë intenzive u punua në krijimin e numrit të parë të Revistës. Me datë 30 mars 2021, në ditën ndërkombëtare të mjekëve, OMK bëri botimin e Revista Mjeku. Kjo revistë botohet për herë të parë në Kosovë, e cila trajton aktualitete të ndryshme nga mjekësia kosovare dhe më gjerë. Tema bosht e këtij numri të parë të revistës është COVID-19. Gjithashtu, janë trajtuar edhe tematika tjera relevante.

Revista Mjeku vjen si rezultat i vizionit dhe angazhimit të Odës së Mjekëve të Kosovës për një revistë informative që i dedikohet mjekut Kosovar dhe lexuesve tjerë potencialë të interesuar në aktualitetet e Shëndetësisë Kosovare. Këshilli Redaktues është i përbërë nga anëtarë të cilët i bashkon bagazhi i madh profesional dhe akademik, por edhe sensi i detyrimit për ta bërë gjithnjë një “hap tutje” në shëndetësinë tonë. Revista është e publikuar edhe online në faqën e Odës së Mjekëve të Kosovës (linku: [REVISTA MJEKU](#)) në mënyrë që të arrijë audiencë sa më të gjerë.

12.2 Kongreset vjetore

Ndër aktivitetet kryesore që Oda e Mjekëve ka planifikuar të realizoj për vitin 2021 janë Kongreset vjetore Mjekësore.

Këshilli Drejtues ka marrë vendim, që Kongreset vjetore të organizuara nga Oda, do të mbahet në muajin Tetor gjegjësisht Nëntor 2021. Kongreset, do të jenë të fokusuara në lëmitë e Onkologjisë interdisciplinare dhe COVID-19 interdisciplinar.

Me datë 27 prill u zgjodh Këshilli Organizativ për Kongresin që ka fokus Onkologjinë deri sa për Kongresin me fokus Covid-19 me datë 14 qershor u zgjodh Komisioni Organizativ. Organizimi i kongreseve bëhet nga ana e OMK-së në bashkëpunim dhe koordinim me institucionet dhe shoqatat profesionale relevante.

12.3 Obelisk kushtuar punëtorëve shëndetësor

Iniciativa për ngritjen e një obelisku në nderim të punës dhe sakrificës së punëtorëve shëndetësorë, u ndërmor nga vet Kryetari i OMK-së, qysh në Tetor 2020. Pas dhënies së mbështetjes për një iniciativë të tillë nga ana e Këshillit Drejtues të OMK-së, u është bërë ftesë për bashkëpunim dhe përkrahje edhe Odave tjetara të Profesionistëve Shëndetësor, e të cilat kanë shprehur gadishmërinë për bashkëorganizim dhe bashkëfinancim për realizimin e këtij projekti.

Odat e Profesionistëve Shëndetësor (OPSh), pas dakordimeve të detajeve të projektit, i janë drejtuar Kryetarit të Komunës së Prishtinës me kërkesë për ndarjen e një hapësire për ndërtimin e këtij obelisku,

Në muajin maj 2021, Kuvendi Komunal i Prishtinës aprovoi projektin dhe ndau parcelën e kërkuar nga OPSh-të.

Ky monument do nderoj sakrificat ndër dekada të punëtorëve shëndetësorë, si në periudhën e helmimit të nxënësve dhe përkujdesjen e të plagosurve të demonstartave gjithëpopullore të viteve '80-të, atëherë në vitet e 90-ta kur regjimi i kohës i hodhi në rrugë, ata në mënyrë të organizuar përmes shoqatës “Nëna Terezë”; Lufta e UÇK-së dhe tani lufta e fundit me COVID-19.

Obesliku është paraparë të jetë me përmasa të përafërta 2.5 metra i gjerë dhe deri në 10 metra i gjatë, kjo në vartësi prej projekteve konkurruese.

12.4 Hulumtim - Të nxënit e harmonizuar/kompetencat e mjekëve të përgjithshëm

Oda e Mjekëve të Kosovës në bashkëpunim me Trupin Këshillëdhënës të Fakultetit të Mjekësisë ka lansuar anketën me temë: Rezultatet e të nxënit të harmonizuar/kompetencat për Mjekët e përgjithshëm. Kjo anketë është hartuar për doktorët e rinj për të vlerësuar njohuritë që ata marrin pas përfundimit të Fakultetit të Mjekësisë, si dhe për shefat e reparteve përkatëse për të marrë vlerësimin e tyre për doktorët e rinjë që i mentorojnë.

Ky hulumtim kishte për dizajn hulumtues metodat deskriptive, me zgjedhje të mostrës të randomizuar. Mostra është përcaktuar përmes kalkulimit të numrit të personave reprezentues të target grupit, që në këtë hulumtim ishin doktorët e rinj. Numri i pjesëmarrësve u përcaktua për të dhënë rezultate signifikante me besueshmëri 95%, i cili ishte 489 pjesëmarrës (doktor të rinjë). Për analizimin e mëtejshëm të rezultateve të nxjerra nga anketimi i doktorëve të rinjë, u përcaktua edhe mostra e shefave të reparteve të cilët dhanë mendimin e tyre në raport me specialistët e rinjë. Në mostrën e grupit të dytë (shefat e reparteve) janë përfshirë 45 pjesëmarrës.

12.5 Hulumtim - Kënaqshmëria e specialistëve me shkollimin specialistik në QKUK dhe Spitale Rajonale

Ky projekt ka për qëllim vlerësimin e kënaqshmërisë dhe përmbushjes së pritshmërive së specialistëve mbi shkollimin specialistik që ata e përcjellin në QKUK dhe Spitale Rajonale. Vlerësimi realizohet nëpërmjet pyetësorit me 14 pyetjeve (të hapura dhe të mbyllura) që do ju shpërndahet specialistëve në institucionet e lartcekura. Përmes pyetësorit synohet të bëhet vlerësimi i kënaqshmërinë mbi mbarëvajtjen e mësimin teorik, mësimin praktik, kushtet e punës, angazhimi i mentorit dhe rekomandimet e specialistëve për përmirësimin e cilësisë së shkollimit të tyre.

Më tutje analiza e të dhënave do të bëhet me Paketën SPSS, dhe rezultatet do t'i bashkangjiten pyetësorit të mëparshëm “Të nxënit e harmonizuar/Kompetencat për Mjekësinë e Përgjithshme” për të nxjerrë konkludimet dhe rekomandimet mbi mbarëvajtjen e shkollimit specialistik.

12.6 Bashkëpunimi profesional dhe veprimtaria ekspertike

Në kuadër të kompetencës publike lidhur me mbikëqyrjen e veprimtarisë profesionale të mjekëve, Kryetari i OMK-së duke u bazuar në kompetencat ligjore sipas Ligjit për OPSH-të, në bazë të kërkesave nga Këshilli Etik i OMK-së dhe Prokurori i OMK-së, ka caktuar ekspertë apo grupe të ekspertëve lidhur me konstatimin e përgjegjësisë profesionale mbi zbatimin e procedurave mjekësore nga mjekët gjegjës.

Organi	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën Prill-Qershor	Vendimet sipas urdhëresave të pranuar për periudhën Prill-Qershor	Në procedurë	Raportet e ekspertizave të përfunduara për periudhën Prill-Qershor	Vendime për lëndët e bartura nga periudhat paraprahe
Kryetari i Odës	2	1	1	0	0

13. Plani i veprimit për vitin 2021

Projektet afatmesme dhe afatgjata

- Projekti për ndërtimin e një objekti për të gjitha OPSH-të mbështetur nga MSH-ja, financuar nga Projekti KSV/017 “Përkrahja për Sektorin e Shëndetësisë”. Kësaj iniciative i janë përgjigjur të gjitha OPSH-të dhe kërkesa zyrtare për mbështetje është nënshkruar nga të gjitha ato dhe më pas është dorëzuar në MSH. Fillimi i ndërtimit pritet pas dhënjes së përlqimit nga ana e ShSKUK-së dhe MSh-së për parcelën për ndërtim. Përlqimi pritet javëve në vijim
- Pas miratimit të kërkesës nga OMK drejtuar LuxDev-it lidhur me përkrahjen financiare për zhvillimin e sistemit informativ/bazës interaktive të të dhënave, ku do të përfshihen të gjitha proceset e OMK-së. Kohëzgjatja e projektit është 1 vit.
- Zbërthimi dhe bartja e kompetencave për edukimin specialistik bazuar në Ligjin për Shëndetësi dhe Ligjin për OPSH-të.
- Botimi i tre vëllimeve të “Revistës Mjeku”
- Organizimi i Kongresit të II vjetor multidisiplinar me fokus Onkologjinë

- Organizimi i Kongresit të III multidisiplinar me fokus COVID-19
- Organizimi i Konferencës ndërkombëtare të Bioetikës
- Organizimi i zgjedhjeve për legjislaturën e III-të të OMK-së